



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, paragrafi 17.1 pika h të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 11 të Udhëzimit administrativ, nr. 01/2015, për transparencë në komuna, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr.01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË**  
**PËR VITIN 2018**

**I.**

Miratohet Vendimi për Planin e veprimit për transparencë për vitin 2018.

**II.**

Plani i veprimit për transparencë, i cekur ne nenin I të këtij vendimi, është bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna dhe legjislacionin tjetër në fuqi, i cili përmban 24 objektiva.

**III.**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit për transparencë për vitin 2018.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Administratës.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-030/01-0105393/18 , më 04.05.2018



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta